



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 787/1 prot.

Tiranë, më 06.03.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi draft-memorandumin e bashkëpunimit me Shërbimin e Policisë Metropolitane në Mbretërinë e Bashkuar *“Për shkëmbimin e informacionit të identifikimit biometrik”*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj me nr. 1736 prot., datë 27.02.2025, protokolluar me tonën nr. 787 prot., datë 28.02.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim *“draft-memorandumin e bashkëpunimit me Shërbimin e Policisë Metropolitane në Mbretërinë e Bashkuar “Për shkëmbimin e informacionit të identifikimit biometrik”* (në vijim, *“draft-memorandumi”*).

Nga shqyrtimi i materialit të dërguar, parashikohet nënshkrimi i një memorandumi bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet shteteve palë, në kuadër të bashkëpunimit policor dhe luftës kundër terrorizmit, për qëllime të sigurisë kombëtare.

Gjithashtu, konstatohet se, bashkëlidhur draft-memorandumit, nuk keni depozituar materialet shoqëruese, të cilave i referoheni si *shtojca nr. 1*, si dhe *shtesat 1A e 1B*, në pikat 1.2. dhe 1.3 të nenit 5, të tij.

Ndërkohë, në dispozitat e draft-memorandumit, citohet se, ndërmjet shteteve palë nënshkruese do të shkëmbehet informacion në lidhje me terrorizmin dhe aktivitetet terroriste, i cili përmban edhe të dhëna biometrike, për individë të dyshuar apo akuzuar për këto vepra penale.

Sipas pikës 24, të nenit 5 të ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* (në vijim *“Ligji”*), të dhënat biometrike konsiderohen të dhëna personale, dhe si të tilla gjejnë rregullim në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për rrjedhojë, Zyra e Komisionerit sugjeron të merren në konsideratë këto ndryshime dhe saktësime në tekstin e draft-memorandumit, në mënyrë që përmbajtja e saj të jetë konform Ligjit.

Duke qenë se, gjatë zbatimit të memorandumit, shtetet palë do të shkëmbejnë informacion, i cili përmban të dhëna personale, si dhe në mbështetje të neneve 47, 50, 70 e 71 të Ligjit, propozojmë që, **në pikën 3 “Përgjegjësitë e përbashkëta”, të nenit 5 të draft-memorandumit**, të shtohen tre pika, me përmbajtje:

“Shkëmbimi i informacionit ndërmjet pjesëmarrësve i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të legjislacioneve për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë në këtë Memorandum Bashkëpunimi”.

“Shkëmbimi i informacioneve që përmbajnë të dhëna personale, do të realizohet duke përdorur mjete të sigurta komunikimi, në përputhje me legjislacionet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë”.

“Në çdo rast, pjesëmarrësit, duhet të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, sipas parashikimeve të legjislacionit specifik dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë të këtij Memorandumi Bashkëpunimi”.

Në vijim, Zyra e Komisionerit ju bën me dije se, sipas pikës 16, të nenit 5 të Ligjit, me termin “Përpunim” konsiderohet çdo veprim ose grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

Për sa më sipër, sugjerojmë që, **pika 13, e nenit 7 të draft-memorandumit** ku parashikohet “Për të shmangur dyshimet, transferimet ndërkombëtare të të dhënave/informacioneve nuk janë të autorizuara nga kjo marrëveshje”, të hiqet, pasi nuk është në përputhje me parashikimet e Ligjit.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit, e vlerëson memorandumin, të hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi